



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

THIRRJE PËR APLIKIM

Për subvencionim vjetor të Klubeve Sportive Publike të cilat do të zhvillojnë aktivitetet sportive sipas plan programit të tyre për vitin 2016.

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjitha Klubet /Shoqatat sportive publike të cilat janë të regjistruara në Komunën e Prishtinës që tashmë janë dëshmuar me përgjegjshmëri dhe qëndrueshmëri në zhvillimin dhe masivizimin e sportit ndër të rinj, gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Sektorit për Rini dhe Sport, konkretisht në fushën e Sportit.

Vlen për klubet sportive që ende nuk kanë aplikuar për subvencionim.

Kërkesa duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit,
- Përshkrimin e aktiviteteve të projektit / plan programit vjetor bashkë me koston e tyre,
- Kostoja që kërkohet nga Komuna,
- Rezultatet e arritura në vitin paraprak.

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Çertifikata e numrit të regjistrimit të OJQ-ës;
- Çertifikata e numrit fiskal të klubit/shoqatës;
- Letërnyoftimi i bartësit të xhirollogarisë;
- Vërtetimi / dëshmia e bankës në emër të klubit/shoqatës/individit;
- Të dhënat e aplikuesit: telefoni , email adresa.

Data e aplikimit është nga **4 mars deri me 18 mars 2016**. Aplikimi bëhet në objektin e vjetër të Komunës, Zyra pritëse (sporteli nr. 5) Adresa Rr. UÇK Nr.2 Prishtinë.

Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të detajuara me lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Prishtinës.

Vërejtje:

Nuk do të merren në shqyrtim:

- Klubet/Shoqatat të cilët nuk kanë përmbyllur projektin nga edicioni i kaluar ndaj DKRS -ës,
- Klubet/Shoqatat të cilët nuk janë përgjigjur kërkesës së DKRS-ës për plotësimin e Formularit të sportit komunal 2016.
- Konkurruesit të cilët nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar.

Nëse keni nevojë për informata shtesë, na kontaktoni.

Tel. Faks: 038/230-900 / 1120
<http://www.kk.rks-gov.net/prishtina>
sporttrini.pr@rks-gov.net